

LIGJ
Nr.9796, datë 23.7.2007

PËR MASAT ANTIDUMPING DHE KUNDËRBALANCUESE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj parashikon rregullat për procedurat dhe kushtet e përcaktimit e të zbatimit të masave antidumping ose kundërbalancuese, për mbrojtjen e industrisë dhe të prodhimit vendas, kur dëmtohen dhe pengohen nga praktikat e pandershme të tregtisë ndërkombëtare, me anë të importeve të dumpuara apo të subvencionuara.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Çmim i eksportit” është çmimi i paguar ose i pagueshëm për produktin, kur shitet për eksport, nga vendi eksportues në Republikën e Shqipërisë.
2. “Dëmtim” është dëmi pasuror, që i shkaktohet industrisë shqiptare, kërcënimi për dëmtim apo pengimi i industrisë shqiptare.
3. “Ministria” është ministria që mbulon tregtinë, e ngarkuar për zbatimin e këtij ligji.
4. “Hetim” është procesi i shqyrtimit për të përcaktuar praninë, shkallën dhe efektin e importeve të dumpuara ose të subvencionuara.
5. “Industria shqiptare” është tërësia e prodhuesve shqiptarë të produkteve të ngjashme ose vetëm ajo pjesë e prodhuesve, produkti i përbashkët i të cilëve përbën pjesën më të madhe të prodhimit të përgjithshëm vendas të këtyre produkteve.
6. “Komisioni për vlerësimin e masave për importet”, në vazhdim “komisioni”, është organi kolegjal shtetëror, që vendos masat antidumping ose kundërbalancuese.
7. “Kufi i dumpingut” është diferenca ndërmjet çmimit të eksportit dhe vlerës normale, në bazë të krahasimit, sipas dispozitave të këtij ligji.
8. “Palë të interesuara” janë:
 - a) eksportuesit ose prodhuesit e huaj të produktit në hetim;
 - b) importuesit e produktit në hetim;
 - c) shoqatat e biznesit ose të tregtisë, pjesa më e madhe e anëtarëve të të cilave janë prodhues, eksportues ose importues të produktit në hetim;
 - ç) qeveritë e vendeve eksportuese;
 - d) prodhuesit shqiptarë të produktit të ngjashëm;
 - dh) shoqatat e biznesit ose të tregtisë, pjesa më e madhe e anëtarëve të të cilave prodhojnë produktin e ngjashëm vendas.
9. “Produkte të ngjashme” është produkti me karakteristika plotësisht të njëjta me produktin në hetim ose, në mungesë të këtij produkti, një produkt tjetër, i cili, megjithëse jo krejtësisht i njëjtë, ka karakteristika shumë të ngjashme me ato të produktit në hetim.
10. “Produkt në hetim” është produkti, objekt i hetimit për masë antidumping ose kundërbalancuese, siç shpjegohet në të dhënat për fillimin e hetimit.

11. "Prodhues të lidhur" janë prodhuesit shqiptarë, të lidhur me eksportues ose importues, kur njëri prej tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kontrollon tjetrin ose të dy së bashku kontrollohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga një person i tretë, apo kur të dy së bashku kontrollojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, një person të tretë.

12. "Subvencion" është kontributi financiar, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i dhënë nga Qeveria në vendin eksportues ose të origjinës, i cili jep një përfitim, siç parashikohet në nenin XVI të GATT-it, 1994.

13. "Shumë e subvencionit" është kontributi financiar, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i ruajtur nga vendi i origjinës apo vendi eksportues për fabrikim, prodhim, eksport apo transport të produktit të shitur për eksport, ose vlera totale e përfitimeve, në formë të ardhurash apo subvencioni të çmimit, siç parashikohet në nenin XVI të GATT-it, 1994.

14. "Vend" është çdo shtet ose territor doganor, anëtar ose jo i Organizatës Botërore të Tregtisë.

15. "Vlerë normale" është çmimi i krahasueshëm, i paguar ose i pagueshëm, nga blerës të pavarur, për produktin e ngjashëm, në kushte normale të trajtimit, kur produkti është i destinuar për konsum, në vendin e origjinës ose në vendin eksportues.

KREU II PËRCAKTIMI I DUMPINGUT

Neni 3 **Parime të përgjithshme**

1. Masa antidumping zbatohet për çdo produkt, objekt i dumpingut, importimi i të cilit në Republikën e Shqipërisë shkakton dëm ose kërcënon të dëmtojë industrinë vendase.

2. Dumpingu ekziston kur çmimi i eksportit të produktit, objekt dumpingu, të eksportuar në Republikën e Shqipërisë, është më i ulët se çmimi i krahasueshëm për produktin e ngjashëm, të destinuar për konsum, në kushtet normale të tregtimit në vendin eksportues.

3. Vendi eksportues është, zakonisht, vendi i origjinës. Megjithatë vend eksportues mund të jetë edhe një vend ndërmjetës, përveç rastit kur produkti kalon tranzit në vendin ndërmjetës ose nuk është prodhuar në vendin ndërmjetës dhe mund të mos ketë çmim në këtë vend.

Neni 4 **Vlera normale**

1. Për të përcaktuar dumpingun, ministria përcakton vlerën normale të produktit. Vlera normale e produktit, kur eksportuesi në vendin eksportues nuk prodhon ose shet produkt të ngjashëm, përcaktohet në bazë të çmimeve të prodhuesve ose shitësve të tjerë. Gjithashtu, çmimet ndërmjet palëve, që duket se janë të lidhura ose kanë një marrëveshjeje shpërblimi me njëri-tjetrin, trajtohen si në kushte jonormale tregtimi dhe nuk përdoren për përcaktimin e vlerës normale, për sa kohë nuk është vërtetuar se këto çmime nuk ndikohen nga këto lidhje.

2. Sasi e mjaftueshme e shitjes së produkteve të ngjashme në tregun e brendshëm të vendit eksportues, për përcaktimin e vlerës normale, do të merret sasia 5 për qind, ose më shumë, e shitjeve në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, mund të merret parasysh edhe një sasi më e vogël shitjesh, kur vërtetohet se kjo sasi mjafton për një krahasim të saktë.

3. Vlera normale e produktit në hetim, kur, në kushtet normale të tregtimit në tregun e brendshëm të vendit eksportues, nuk ka shitje të produktit të ngjashëm ose kur, për shkak të situatës së veçantë të tregut apo vëllimit të ulët të shitjeve në tregun e brendshëm të vendit eksportues, shitje të tilla nuk lejojnë një krahasim të saktë, përcaktohet një vlerë përfaqësuese, në kushte normale tregtimi, kur eksportohet në një vend të tretë.

4. Vlera normale llogaritet në bazë të kostos së prodhimit në vendin e origjinës plus vlerën e përcaktuar në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji, për kostot e përgjithshme administrative dhe të një fitimi të arsyeshëm, në përputhje me rregullat ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 5

Trajtimi i shitjeve nën kosto, si shitje në kushte jonormale tregtimi

Në përcaktimin e vlerës normale, ministria merr parasysh shitjet në kushte normale. Shitjet e produktit të ngjashëm në tregun e brendshëm të vendit eksportues ose shitjet në një vend të tretë, me një çmim më të ulët se kostoja e përgjithshme për njësi prodhimi, trajtohen, për shkak të çmimit, si shitje në kushte jonormale tregtimi dhe nuk merren parasysh në përcaktimin e vlerës normale, vetëm nëse ministria përcakton se:

- a) shitje të tilla janë bërë për një periudhë të përcaktuar kohe (normalisht një vit, por në asnjë rast më pak se gjashtë muaj);
- b) shitje të tilla bëhen në sasi të konsiderueshme;
- c) mesatarja e ponderuar e çmimit të shitjes së transaksioneve në shqyrtim është më e ulët se mesatarja e ponderuar e kostove për njësi ose vëllimi i shitjeve nën kosto për njësi përbën jo më pak se 20 për qind të vëllimit të shitur të transaksioneve;
- ç) shitje të tilla bëhen me çmime, që nuk mbulojnë të gjitha kostot brenda një periudhe të caktuar kohe.

Nëse çmimet nën kosto për njësi, në kohën e shitjeve, janë mbi mesataren e ponderuar të kostove për njësi, në periudhën e hetimit, ministria llogarit se këto çmime lejojnë mbulimin e kostove brenda një periudhe të arsyeshme kohe.

Neni 6

Llogaritja e kostove që merren parasysh në përcaktimin e vlerës normale

1. Ministria, si rregull, llogarit dy lloje kostosh në bazë të të dhënave nga eksportuesi apo prodhuesi në hetim dhe nga subjekti/et e dëmtuara, që janë ankuar, me kusht që të dhënat të jenë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të vendit eksportues dhe të pasqyrojnë, në mënyrë të arsyeshme, kostot e lidhura me produktin dhe me shitjen e produktit në shqyrtim.

2. Vlera e kostove të përgjithshme, administrative dhe të shitjes, si dhe vlera e fitimit llogariten në bazë të të dhënave në çastin e llogaritjes së kostos. Këto vlera janë të lidhura me prodhimin dhe shitjet, në kushte normale tregtimi, të produktit të ngjashëm, nga eksportuesi apo prodhuesi në hetim. Kur vlerat nuk mund të përcaktohen mbi këtë bazë, atëherë do të përcaktohen në mbështetje të:

- a) mesatares së ponderuar të vlerave në atë çast, të përcaktuara për eksportues apo prodhues të tjerë, të cilët janë subjekte hetimi, që prodhojnë dhe shesin produktin e ngjashëm në tregun e vendit të origjinës;
- b) vlerave në atë çast, të zbatueshme për prodhimin dhe shitjen, në kushte normale tregtimi, të së njëjtës kategori të përgjithshme të produkteve, për eksportuesin apo prodhuesin në fjalë, në tregun e vendit të origjinës;
- c) çdo metode tjetër të arsyeshme, duke siguruar që vlera e vendosur për fitim të mos kalojë fitimin e realizuar normalisht nga eksportues apo prodhues të tjerë, gjatë shitjes së produkteve të së njëjtës kategori të përgjithshme, në tregun e vendit të origjinës.

3. Nëse njëra nga palët ka pretendime për llogaritjen e kostos, të bërë nga ministria, ajo, me shpenzimet e veta, mund të kërkojë ekspert të pavarur për të rillogaritur koston, pasi të ketë marrë miratimin e të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces.

Neni 7

Çmimi i eksportit

1. Ministria, krahas vlerës normale, përcakton edhe çmimin e eksportit, në kuptim të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Ministria, kur mungon çmimi i eksportit ose kur ky çmim vlerësohet i pasaktë, për shkak të një marrëveshjeje për shpërblim, ndërmjet eksportuesit dhe importuesit ose një pale të tretë, e llogarit çmimin sipas kritereve të mëposhtme:

- a) në bazë të çmimit, me të cilin produktet e importuara i janë rishitur një blerësi të pavarur;
- b) me një çmim të arsyeshëm, që përcaktohet nga ministria, kur produktet nuk i janë rishitur

një blerësi të pavarur ose nuk janë rishitur në gjendjen, në të cilën janë importuar.

Në këto raste në çmimin e eksportit do të llogariten të gjitha kostot, përfshirë detyrimet dhe taksat, si dhe fitimet, që rezultojnë ndërmjet importimit dhe rishitjes. Në këtë kuadër, do të merren parasysh zëra të tilla të koston, si:

- i) kostoja e transportit, sigurimit, ngarkim-shkarkimit dhe kostoja ndihmëse;
- ii) taksa doganore, çdo taksë antidumping, taksa të tjera dhe detyrime fiskale shtesë;
- iii) kostoja e shitjes, kostoja, administrative dhe e përgjithshme, si dhe fitimi.

Neni 8

Krahasimi i vlerës normale me çmimin e eksportit

1. Në mënyrë që vlera normale dhe çmimi i eksportit të jenë të krahasueshëm, duhet që krahasimi të bëhet në të njëjtin nivel tregtie, normalisht në nivelin e fabrikës. Gjatë krahasimit duhet të kihet parasysh karakteristikat fizike të produktit, sasia dhe termat e shitjeve, të bëra në atë çast ose në kohën më të afërt të mundshme, si dhe ndryshime të tjera, të cilat ndikojnë në krahasim.

2. Nëse vlera normale dhe çmimi i eksportit nuk janë të krahasueshëm, në bazë të karakteristikave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ato duhet të përshtaten dhe të rregullohen, duke pasur parasysh ndryshimet në karakteristikat, për të cilat është pretenduar dhe vërtetuar se ndikojnë në çmimet dhe në krahasimin e çmimeve. Karakteristikat, tek të cilat lejohet të bëhen rregullime, janë:

a) karakteristikat fizike. Ndryshimet në karakteristikat fizike të produktit duhet të bëhen duke mbajtur parasysh faktin se si këto ndryshime ndikojnë në çmimin e tregut në vendin e origjinës ose në vendin nga është eksportuar. Nëse mungojnë të dhënat e çmimit të vendit të origjinës ose të dhënat nuk janë të përshtatshme për një krahasim të saktë, llogaritja mbështetet në ndryshimet në koston e prodhimit, të cilat ndikohen nga ndryshimet në karakteristikat fizike dhe masa e rregullimit duhet t'i përgjigjet një vlerësimi të arsyeshëm të vlerës së tregut të ndryshimit;

b) taksat e importit dhe taksat indirekte. Rregullimi i ndryshimeve në taksat e importit dhe taksat indirekte duhet të ketë parasysh faktin se produkti është importuar në Republikën e Shqipërisë dhe, si i tillë, disa nga taksat e importit dhe taksat indirekte, të pagueshme për këtë produkt apo materialin/et e përdorur/a në të, kur janë për konsum në vendin e origjinës ose në vendin eksportues, nuk janë të zbatueshme dhe se këto taksa mund të rimbursohen. Masa e rregullimit duhet t'u përgjigjet vlerës së taksave të importit dhe/ose taksave indirekte;

c) zbritjet, rabatet dhe sasi. Rregullimi për ndryshimet në zbritjet dhe rabatet duhet të përfshijë edhe rregullimet për ndryshimet në sasi, nëse këto sasi janë të përcaktuara si duhet dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me shitjet në fjalë;

ç) niveli i tregtisë. Rregullimi i ndryshimeve në nivelin e tregtisë, përfshirë edhe ndonjë ndryshim që mund të dalë në shitje, bëhet kur, në varësi të rrjetit shpërndarës në të dyja tregjet, tregohet se çmimi i eksportit, përfshirë një çmim eksporti të ndërtuar, është në një nivel tregtie të ndryshëm nga ai i vlerës normale e se ndryshimi ka ndikuar në krahasueshmërinë e çmimit, që është shfaqur nga ndryshime të dukshme e të vazhdueshme në çmimet e shitësit, për nivelet e ndryshme të tregtisë në tregun e vendit të origjinës. Masa e rregullimit do të bazohet në vlerën e tregut të ndryshimit;

d) kostot e transportit, të sigurimit, tregtimit, të ngarkim-shkarkimit dhe kostot ndihmëse. Rregullimi bëhet për ndryshimet në kostot e lidhura, në mënyrë të drejtpërdrejtë, të ndodhura gjatë transportimit të produktit në fjalë nga godinat e eksportuesit te një blerësi i pavarur, kur kosto të tilla janë të përfshira në çmimet e vendosura. Këto kosto do të përfshijnë kostot e transportit, të sigurimit, tregtimit, të ngarkim-shkarkimit dhe kostot ndihmëse;

dh) paketimi. Rregullimi bëhet për ndryshimet në kostot e paketimit, të lidhura, në mënyrë të drejtpërdrejtë, për produktin në fjalë;

e) kreditë. Rregullimi bëhet për ndryshimet në koston e një kredie të dhënë për shitjet në fjalë, nëse është një faktor, i cili është pasur parasysh në përcaktimin e çmimeve të vendosura;

ë) kostot e passhitjeve. Rregullimi bëhet për ndryshimet në kostot e drejtpërdrejta të sigurimit të garancive, pengjeve, asistencës dhe shërbimeve teknike, siç janë parashikuar në ligj dhe/ose në kontratën e shitjeve;

f) komisionet. Rregullimi bëhet për ndryshimet në komisionet e paguara për shitjet në fjalë;

g) këmbimi i monedhës. Kur krahasimi kërkon konvertim të monedhës, një këmbim i tillë

bëhet duke përdorur kursin zyrtar të këmbimit në datën e shitjeve. Data e shitjes është data e faturës, por mund të merret edhe data e kontratës, e porosisë së blerjes, e konfirmimit të porosisë, nëse në to janë përcaktuar më saktë kushtet materiale të shitjes. Luhatjet në kursin e këmbimit nuk do të merren parasysh dhe eksportuesve do t'u lihet, të paktën, 60 ditë kohë për të rregulluar çmimet e tyre të eksportit e për të pasqyruar lëvizjet e bëra në kurset e këmbimit gjatë periudhës së hetimit.

Neni 9 **Marzhi i dumpingut**

1. Marzhi i dumpingut nënkupton përqindjen, në të cilën vlera normale është më e madhe se çmimi i eksportit.

2. Vlera e marzhit të dumpingut përcaktohet duke krahasuar mesataren e ponderuar të vlerave normale me mesataren e ponderuar të çmimeve të eksportit të të gjitha transaksioneve, ose duke krahasuar për çdo transaksion vlerën normale individuale me çmimin individual të eksportit.

Vlera e marzhit të dumpingut, e përcaktuar në bazë të mesatares së ponderuar, mund të krahasohet me të gjitha çmimet e transaksioneve individuale të eksportit, edhe kur ka një listë të çmimeve të eksportit nga blerës, rajone ose periudha kohore të ndryshme dhe kur metodat e përcaktuara në këtë pikë nuk reflektojnë shkallën e plotë të dumpingut të praktikuar.

3. Në rast se marzhi i dumpingut është i ndryshueshëm, mund të përdoret mesatarja e ponderuar e të gjitha marzheve të llogaritura.

KREU III PËRCAKTIMI I SUBVENCIONIMIT

Neni 10 **Parimi i përgjithshëm**

Masa kundërbalancuese vendoset kundrejt subvencionit specifik për produktet e importuara në tregun shqiptar, të cilat i shkaktojnë dëm ose kërcënim për dëm industrisë vendase.

Neni 11 **Përcaktimi i subvencionimit**

Në kuptim të këtij ligji, subvencionim kemi nëse:

a) ka kontribut financiar nga Qeveria ose nga një organ tjetër shtetëror në territorin e një vendi, kur Qeveria:

i) bën pagesa publike, me pasojë transferimin e drejtpërdrejtë të fondeve si kredi ndihme, hua, hyrje kapitali, transferime të mundshme të drejtpërdrejta fondesh ose garanci mbi huatë;

ii) heq dorë nga marrja e pagesave, që i detyroheshin asaj ose nuk i mbledh këto detyrime, si në rastin e incentivëve fiskalë, si kredi taksimi, në përputhje me dispozitat e nenit XVI të GATT-it, 1994;

iii) siguron të mira ose shërbime të ndryshme nga infrastrukturat e përgjithshme ose blen të mira;

iv) kryen derdhje në një mekanizëm financimi ose ngarkon apo i jep urdhra një enti privat të kryejë një apo disa prej funksioneve të përmendura në nënndarjet “i”, “ii” e “iii” më lart, që me ligj i takojnë Qeverisë dhe veprimtaria e kryer të mos ndryshojë, në thelb, nga praktikatat e ndjekura nga Qeveria;

b) ekziston çfarëdo forme të ardhurash ose mbështetjeje çmimi, sipas nenit XVI të GATT-it, 1994;

c) në këtë mënyrë arrihet një përfitim.

Përjashtimi i një produkti të eksportuar nga detyrimet apo taksat, nëse produkti është për konsum në tregun e brendshëm, ose përjashtimi nga detyrimet apo taksat e importit nuk i kalon kufijtë e detyrimeve të pagueshme, nuk vlerësohet subvencion.

Neni 12

Subvencionet specifike

1. Subvencionet janë subjekt i zbatimit të masave kundërbalancuese vetëm nëse ato janë specifike. Subvencioni është specifik për një ndërmarrje ose industri apo për një grup prej tyre, që më pas përkufizohen “ndërmarrje specifike”, kur autoriteti që e përcakton, ose legjislacioni, në bazë të të cilit vepron ky autoritet, kufizon, në mënyrë të qartë, mundësinë e marrjes së tyre nga ndërmarrje të caktuara.

2. Subvencioni nuk është specifik kur autoriteti që e përcakton ose legjislacioni, në bazë të të cilit vepron ky autoritet, cakton kritere apo kushte objektive, të cilat disiplinojnë dhënien e detyrimit dhe të shumës, me kusht që detyrimi të jetë i menjëhershëm dhe këto kritere e kushte të respektohen me rreptësi.

Kritere ose kushte objektive janë kriteret dhe kushtet që janë neutrale, që nuk favorizojnë ndërmarrje të caktuara dhe që janë të një natyre ekonomike dhe me zbatim horizontal, siç është numri i punonjësve ose përmasat e ndërmarrjes. Kriteret ose kushtet objektive duhet të shpjegohen me hollësi në ligj ose/dhe në dokumente të tjera zyrtare, të cilat mund të verifikohen.

Kur mendohet se kemi një subvencion specifik, edhe pse nuk qëndron specifikimi i bërë në paragrafin e mësipërm, mund të merren parasysh faktorë të tjerë, si për shembull: përdorimi i një programi subvencionesh nga një numër i kufizuar ndërmarrjesh, frytshmëria e ndjeshme për ndërmarrje të caktuara, dhënia e subvencioneve jashtë përmasave që vlerësohen të larta për ndërmarrje të caktuara, mënyra sesi autoriteti dhënës ka ushtruar pushtetin në marrjen e vendimit për dhënien e subvencionit. Për këtë pikë të fundit do të mbahen parasysh të dhënat për rastet e refuzimit apo të miratimit të kërkesave për subvencion dhe arsyetimi i vendimeve.

3. Vlerësohet specifik subvencioni i kufizuar për disa ndërmarrje të përcaktuara, të vendosura në një zonë gjeografike të caktuar, brenda juridiksionit të autoritetit dhënës.

Vënia ose ndryshimi i shkallës së taksave me zbatim të përgjithshëm, nga çdo nivel i administratës publike, që e ka këtë kompetencë, nuk vlerësohet subvencion specifik për qëllimet e këtij ligji.

4. Pavarësisht nga dispozitat e pikave 1 e 2, vlerësohen specifike subvencionet e mëposhtme:

a) subvencionet e kushtëzuara, në ligj ose në fakt, që ndikojnë në performancën e eksporteve.

Vlerësohet subvencion i kushtëzuar që ndikon në performancën e eksportimeve, kur vërtetohet se dhënia e një subvencioni të tillë edhe pse nuk është bërë ligjërisht i kushtëzuar që ndikon në performancën e eksporteve, në fakt rezulton i lidhur me përfitimet nga eksportet aktuale ose të pritshme;

b) subvencione të kushtëzuara, që ndikojnë në përdorimin e produkteve vendase ndaj atyre të importuara.

5. Përcaktimi i specifikimit, sipas dispozitave të këtij neni, duhet të provohet qartësisht, në bazë të të dhënave pozitive.

Neni 13

Llogaritja e shumës së subvencionit kundërbalancues

1. Shuma e subvencionit kundërbalancues duhet të llogaritet në përputhje me përfitimin, që i është dhënë marrësit të subvencionit.

2. Periudha e hetimit do të jetë viti i fundit i mbajtjes së llogarive nga përfituesi, por mund të jetë edhe një periudhë prej të paktën 6 muajsh përpara fillimit të hetimit, për të cilin ka të dhëna financiare të besueshme.

Neni 14

Llogaritja e përfitimit të marrësit të subvencionit

Për llogaritjen e përfitimit të marrësit të subvencionit zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) blerja e kapitalit aksioner nga Qeveria nuk vlerësohet se sjell përfitim, por vetëm nëse investimi, në territorin e vendit të origjinës dhe/ose të vendit eksportues, jo sipas praktikës së

zakonshme të investimit (që përfshin vlerën e riskut të kapitalit aksioner);

b) një hua nga një qeveri nuk vlerësohet se sjell përfitim, por vetëm nëse ekziston një diferencë ndërmjet shumës, që shoqëria huamarrëse paguan mbi huanë qeveritare dhe shumës që do të paguante për një hua tregtare të krahasueshme, të cilën ajo mund ta merrte në treg. Në këtë rast, përfitimi do të ishte diferenca ndërmjet këtyre dy shumave;

c) garancia e huasë nuk vlerësohet se sjell përfitim, por vetëm nëse ekziston një diferencë ndërmjet shumës, që shoqëria, e cila merr garancinë, paguan mbi huanë e garantuar nga Qeveria dhe shumës që do të paguante për një hua tregtare të krahasueshme, në mungesë të një garancie qeveritare. Në këtë rast, përfitimi do të ishte diferenca ndërmjet këtyre dy shumave, e rregulluar për ndonjë ndryshim në pagesa;

ç) shitja ose blerja e mallrave dhe ofrimi i shërbimeve nga Qeveria nuk do të vlerësohen se sjellin përfitime, por vetëm nëse janë bërë nën çmimin e tregut ose kur blerja është bërë për më shumë se çmimi i tregut. Çmimi i tregut përcaktohet në bazë të kushteve të tregut ekzistues për produktin apo për shërbimin në fjalë në vendin e shitjes ose të blerjes, së bashku me çmimin, cilësinë, vlefshmërinë, tregtueshmërinë, transportin dhe kushtet e tjera të blerjes ose të shitjes.

Neni 15

Parime të përgjithshme të llogaritjes

1. Shuma e subvencioneve kundërbalancuese llogaritet për njësi produkti të subvencionuar, të eksportuar në Republikën e Shqipërisë.

2. Nga llogaritja e kësaj shume mund të zbriten:

a) taksa e aplikimit dhe shpenzime të tjera, të nevojshme për të siguruar subvencionin;

b) detyrimet e eksportimit, taksat ose pagesat e tjera, të cilat i zbriten këtij produkti të eksportuar në Republikën e Shqipërisë që, në mënyrë specifike, synojnë të kompensojnë subvencionin.

3. Subjekti, që kërkon zbritje, duhet të jetë bindës në kërkesën e vet.

4. Kur subvencioni nuk jepet në përputhje me sasinë e fabrikuar, të eksportuar ose të transportuar, shuma e subvencionit kundërbalancues përcaktohet duke shpërndarë drejt vlerën totale të subvencionit, sipas nivelit të prodhimit, shitjes ose eksportimit të produkteve në fjalë, për periudhën, objekt hetimi i subvencioneve.

5. Kur subvencioni çon në shitje, të tanishme ose të pritshme, të një aktivi fiks, shuma e subvencioneve kundërbalancuese llogaritet duke e shpërndarë këtë të fundit për një periudhë, që përkon me periudhën normale të amortizimit të këtij aktivi fiks në sektorin në fjalë. Shuma e llogaritur në këtë mënyrë i ngarkohet periudhës së hetimit, duke pasur parasysh se shuma që rrjedh nga aktivet fikse, të siguruar përpara kësaj periudhe, shpërndahet siç është parashikuar në pikën 4 të këtij neni.

Kur aktivet janë të pazhvlerësueshme, subvencioni vlerësohet si hua pa interes dhe trajtohet në përputhje me dispozitat e shkronjës “b” të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 16

Mënyrat e llogaritjes së shumës së subvencionimit

1. Shuma e subvencionimit të një prodhuesi ose eksportuesi të huaj për produktin në hetim llogaritet për çdo subvencion të hetuar ose program për subvencion, në përputhje me pikën 2 të këtij neni. Totali i këtyre shumave për subvencion ose program subvencioni do të jetë shuma totale e subvencionimit të prodhuesit ose eksportuesit për këtë produkt.

2. Komisioni, për llogaritjen e shumës së subvencionimit të disa prodhuesve të huaj ose eksportuesve të produktit në hetim, nga një subvencion ose program subvencioni të caktuar, përcakton:

a) në fazën e parë, shumën totale të subvencionimit të prodhuesit apo eksportuesit nga një subvencion ose program subvencioni i caktuar, si dhe datën e marrjes së subvencionit;

b) në fazën e dytë, atë pjesë të shumës totale të subvencionimit, e cila do t'i ngarkohet periudhës së hetimit të subvencionit;

c) në fazën e tretë, shumën totale të shitjes (gjatë periudhës së hetimit të subvencionit) të prodhuesit të huaj ose eksportuesit, të cilit do t'i atribuohet periudha e hetimit të subvencionit.

Neni 17

Llogaritja e shumës së subvencionit specifik

1. Komisioni, si rregull, përcakton një shumë subvencioni specifik për secilin prodhues të huaj, të njohur ose eksportues, që punon me produktin në hetim.

2. Komisioni, pavarësisht nga përcaktimi i bërë në pikën 1 të këtij neni, kur numri i eksportuesve, prodhuesve, importuesve të interesuar të llojeve të produkteve është shumë i madh, mund ta kufizojë hetimin në një numër palësh të interesuara ose produktesh në hetim, duke përdorur shembuj statistikisht të vlefshëm, në bazë të të dhënave që ka, në kohën e zgjedhjes, ose deri në përqindjen më të madhe të rajonit të eksportit nga ai vend që, në mënyrë të arsyeshme, mund të hetohet.

3. Çdo përzgjedhje nga eksportuesit, prodhuesit, importuesit e interesuar të llojeve të produkteve, e bërë në përputhje me pikën 2 të këtij neni, bëhet pas këshillimeve me eksportuesit, prodhuesit ose importuesit.

4. Kur komisioni, në përputhje me pikat 2 e 3 të këtij neni, kufizon hetimin, ai përcakton një shumë subvencioni specifik për secilin prodhues të huaj, të njohur ose eksportues, i cili vullnetarisht dhe në kohë paraqet dokumentet e nevojshme, që do të kihet parasysh gjatë hetimit. Pavarësisht nga pohimi i mëparshëm, kur numri i eksportuesve ose prodhuesve është i madh, saqë hetimet specifike do të ishin mbingarkesë për komisionin, ai mund të refuzojë përcaktimin e masave të subvencioneve specifike, në bazë të përgjigjeve të tilla dhe mund ta kufizojë hetimin vetëm për eksportuesit dhe prodhuesit.

KREU IV

VLERËSIMI I DËMIT TË SHKAKTUAR NGA DUMPINGU OSE SUBVENCIONI DHE LIDHJA SHKAKËSORE

Neni 18

Përcaktimi i dëmit

1. Përcaktohet dëm ose kërcënim për një dëm nga importet e dumpuara ose të subvencionuara, jo vetëm kur, në mënyrë të drejtpërdrejtë, i shkakton dëme industrisë vendase, por edhe kur sjell ngadalësimin e ndjeshëm të zhvillimit ose pengon krijimin e kësaj industrie.

2. Përcaktimi i dëmit bazohet në të dhënat e industrisë dhe përfshin shqyrtimin e elementeve të mëposhtme:

a) vëllimit të importeve të dumpuara ose të subvencionuara, veçanërisht nëse ky vëllim ka pësuar rritje në terma absolutë ose relativë në raport me prodhimin apo konsumin në Republikën e Shqipërisë;

b) sasisë së mallrave të dumpuara ose të subvencionuara, krahasuar me nevojat e tregut të vendit importues për këto mallra;

c) efektit të importeve të dumpuara ose të subvencionuara në çmimin e produkteve të ngjashme në tregun e Republikës së Shqipërisë;

ç) ndikimit të mëtejshëm të këtyre importeve mbi prodhuesit e brendshëm të produkteve të ngjashme në Republikën e Shqipërisë. Ky element mund të matet me treguesit ekonomikë, ekzistues ose potencialë, si rënia e shitjeve, zotërimi i tregut, produktiviteti, fitimi, ndikimi negativ në rezerva, punësimi, pagat, likuiditetet, investimet dhe niveli i çmimeve.

Neni 19

Shqyrtimi i vëllimit të importeve të dumpuara ose të subvencionuara dhe efekti i tyre mbi çmimet

1. Ministria, për vëllimin e importeve të dumpuara ose të subvencionuara, u kërkon organeve doganore raport mujor, kur ka rritje të ndjeshme të importeve të subvencionuara, qoftë në terma absolutë, qoftë në krahasim me prodhimin apo konsumin në Republikën e Shqipërisë.

2. Për sa u përket efekteve të importeve të dumpuara ose të subvencionuara në çmimet në tregun vendas, ministria shqyrton:

a) nëse ka pasur rënie të theksuar çmimi, që ka çuar deri në ndërprerje të prodhimit të produktit të ngjashëm;

b) nëse është penguar, në një shkallë të ndjeshme, rritja e çmimeve, që normalisht duhej të ndodhte.

Neni 20

Akumulimi

Kur importet e produkteve të ngjashme nga më shumë se një vend janë njëherësh objekt i hetimeve për masa antidumping ose kundërbalancuese, komisioni vlerëson, në mënyrë të përmblëdhur, efektet e tyre, vetëm nëse ministria përkatëse përcakton se:

a) marzhi i dumpingut ose shuma e subvencioneve, të vendosura për importet nga secili vend, është më i lartë se minimali, siç përcaktohet në nenin 27 të këtij ligji dhe se vëllimi i importeve nga secili vend është i ndjeshëm;

b) vlerësimi përmblëdhës i efekteve të importeve, në lidhje me konkurrencën, ndërmjet produkteve të importuara dhe produkteve të ngjashme vendase, është i përshtatshëm.

Neni 21

Shqyrtimi i ndikimit të vëllimit të importeve të dumpuara ose të subvencionuara në industrinë vendase

1. Komisioni, gjatë shqyrtimit të ndikimit të vëllimit të importeve të dumpuara ose të subvencionuara në industrinë shqiptare, vlerëson të gjithë faktorët dhe treguesit ekonomikë përkatës, që ndikojnë në industri, të tillë si:

a) rënien reale apo të mundshme të shitjeve, të fitimeve, prodhimit, zotërimin e tregut, produktivitetin, kthimin nga investimet, si dhe shfrytëzimin e kapacitetit;

b) faktorët, që ndikojnë në çmimet vendase;

c) efektet negative, reale e të mundshme, mbi fluksin e parasë, punësimin, pagat, në rritjen, aftësinë për rritjen e kapitalit ose të investimeve;

ç) marzhin e dumpingut ose shumat e subvencioneve.

2. Komisioni vlerëson efektet e importeve të dumpuara ose të subvencionuara mbi prodhimin shqiptar të produkteve të ngjashme, në bazë të të dhënave, që mundësojnë identifikimin e atij produkti, sipas procesit të prodhimit, shitjeve dhe fitimeve të prodhuesit. Nëse për produktin nuk është i mundur një identifikim i tillë, atëherë efektet e importeve të dumpuara ose të subvencionuara vlerësohen duke shqyrtuar prodhimin e grupit më të ngushtë të produkteve, që përfshin produkte të ngjashme, për të cilat mund të sigurohen të dhënat e nevojshme.

Neni 22

Kërcënimi për dëm material

1. Kërcënimi për dëm material përcaktohet si një situatë, gjatë së cilës mund të ndodhë një dëm thelbësor.

2. Komisioni përcakton ekzistencën e kërcënimit për dëm material në bazë të fakteve.

3. Komisioni, në përcaktimin e ekzistencës së kërcënimit për dëm material, përveç faktorëve të përmendur në nenin 21 të këtij ligji, shqyrton edhe këta faktorë:

a) llojin e subvencionit/eve dhe efektet e mundshme në treg;

b) normën e rritjes së importeve të dumpuara ose të subvencionuara, për të parë prirjen e kësaj norme;

c) çmimet e importeve, për t'i paraprirë një efekti diskriminues të çmimeve të produkteve shqiptare, gjë që do të rriste kërkesën për importe të mëtejshme;

ç) rritjen e kapacitetit të eksportuesve, gjë që do të rriste ndjeshëm futjen në tregun vendas të importeve të dumpuara ose të subvencionuara, duke pasur parasysh tregje të tjera eksporti, që mund të thithin eksporte shtesë;

d) ofertën ose inventarët e produkteve në hetim.

4. Kur vërtetohet se ekziston kërcënim për dëm, i shkaktuar nga importi i dumpuar ose i subvencionuar, komisioni merr vendime për zbatimin e masave antidumping ose kundërbalancuese.

Neni 23
Lidhja shkakësore

1. Komisioni, pas shqyrtimit të të dhënave përkatëse, për faktorët e përcaktuar në nenet 18 – 22 të këtij ligji, vërteton ekzistencën ose jo të një lidhjeje shkakësore ndërmjet importeve të dumpuara ose të subvencionuara dhe dëmit apo kërcënimit për dëm thelbësor të prodhuesve vendas.

2. Komisioni, përveç importeve të dumpuara ose të subvencionuara, shqyrton edhe faktorët e tjerë, të cilët, në njëjtën kohë, dëmtojnë industrinë shqiptare dhe dëmet e shkaktuara prej tyre nuk duhet t’u atribuohen importeve të dumpuara ose të subvencionuara. Ndër faktorët e tjerë, që mund të ndikojnë në dëm apo kërcënim për dëm, janë:

- a) vëllimi dhe çmimet e eksportit të padumpuar ose të pasubvencionuar të një produkti të veçantë;
- b) ulja e kërkesës ose ndryshimet e modeleve të konsumit;
- c) praktikat, që kufizojnë tregtinë dhe konkurrencën ndërmjet prodhuesve vendas dhe të huaj;
- ç) zhvillimet teknologjike;
- d) eksportet e realizuara dhe produktiviteti i industrisë vendase.

KREU V
ORGANET E HETIMIT

Neni 24

Ministria që mbulon tregtinë është institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji për instrumentet rregulluese në tregtinë ndërkombëtare.

Neni 25
Komisioni për vlerësimin e masave për importet

1. Shqyrtimi i masave antidumping, masave kundërbalancuese dhe masave mbrojtëse në importe, në zbatim të këtij ligji, bëhet nga komisioni për vlerësimin e masave për importet, i cili është krijuar dhe funksionon, përkatësisht, sipas neneve 4 dhe 5 të ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe”.

2. Përveç kompetencave të përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe”, komisioni harton rregullat e aplikimit dhe të procedurave të masave antidumping dhe kundërbalancuese.

KREU VI
FILLIMI I HETIMEVE

Neni 26

Kushtet për aplikim dhe plotësimi i formularëve

1. Hetimi për të përcaktuar ekzistencën, shkallën dhe efektin e importeve të dumpuara ose të subvencionuara dhe lidhjet shkakësore ndërmjet tyre fillon me kërkesën me shkrim nga/në emër të industrisë shqiptare. Në raste të veçanta, ministria i fillon hetimet me nismën e vet dhe me miratimin e komisionit. Në këtë rast, ministria duhet të ketë prova të mjaftueshme, në kuptim të kreut IV të këtij ligji.

2. Për aplikimet përdoren formularë, të cilët miratohen nga komisioni e që merren pranë ministrisë dhe përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin, adresën dhe numrin e telefonit të aplikantit;
- b) emrat, adresat dhe numrat e telefonit të të gjithë prodhuesve vendas, të produkteve të ngjashme, në emër të të cilëve bëhet aplikimi;
- c) të dhënat për masën e mbështetjes së industrisë shqiptare për aplikimin, përfshirë vlerën dhe vëllimin e përgjithshëm të prodhimit shqiptar të produktit të ngjashëm dhe vëllimin e vlerën e produktit të ngjashëm, të prodhuar nga aplikanti ose nga çdo prodhues shqiptar i identifikuar;

ç) një përshkrim të produktit, që pretendohet se është i dumpuar ose i subvencionuar, përfshirë karakteristikat teknike dhe kodin e tij tarifor;

d) vendin ku produkti i pretenduar si i dumpuar ose i subvencionuar është prodhuar ose fabrikuar dhe, nëse është importuar nga një vend tjetër, vendin ndërmjetës, nga i cili është importuar produkti;

dh) emrat dhe adresat e çdo eksportuesi apo prodhuesi të huaj dhe listën e personave, që njihen si importues të produktit në fjalë;

e) të dhënat për çmimin e produktit, objekt dumpingu, nëse produkti është parashikuar për shitje në tregun e vendit të origjinës, të vendit eksportues ose për ekzistencën, sasinë dhe natyrën e subvencionit specifik;

ë) lidhjen shkakësore ndërmjet importeve të dumpuara ose të subvencionuara dhe dëmtimit të shkaktuar industrisë vendase. Të dhëna për rritjen e vëllimit të importeve, që pretendohet se janë të dumpuara ose të subvencionuara, efektin dhe pasojat e mëtejshme në çmimet e produkteve të ngjashme vendase në tregun shqiptar, siç tregohet nga faktorët dhe treguesit përkatës, që ndikojnë në gjendjen e industrisë shqiptare.

Neni 27

Vendimi për të filluar hetimin

1. Ministria, pasi shqyrton saktësinë dhe mjaftueshmërinë e të dhënave të paraqitura në aplikim, ia paraqet komisionit për vlerësim. Aplikuesit mund t'i kërkojnë të dhëna të mëtejshme, përpara marrjes së vendimit për fillimin e hetimit.

2. Kur komisioni vendos të nisë hetim, pa marrë një kërkesë të shkruar nga/ose në emër të industrisë së vendit, vendimi bazohet mbi të dhëna të mjaftueshme për dumpingun ose subvencionin, dëmin dhe lidhjen shkakësore, sipas kreut IV të këtij ligji.

3. Në marrjen e vendimit për fillimin e hetimit mbahen parasysh edhe të dhënat për dumpingun ose subvencionet dhe dëmin e shkaktuar. Kërkesa për fillimin e hetimit refuzohet, kur nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të justifikuar vazhdimin e procesit. Nuk ndërmerren veprime ndaj vendeve, importet e të cilave përfaqësojnë një pjesë tregu prej më pak se 1 për qind, vetëm nëse këto vende, bashkërisht, llogariten më shumë se 3 për qind e konsumit vendas.

4. Hetimi nuk fillon, sipas pikave 1 e 2 të nenit 26 të këtij ligji, në rast se nuk përcaktohet në bazë të një kontrolli se:

a) kërkesa e shkruar është bërë nga/ose në emër të industrisë së vendit;

b) shkalla e mbështetjes ose e kundërshtimit të kërkesës për aplikim është shprehur nga industria vendase e produktit të ngjashëm.

5. Aplikimi vlerësohet i bërë “nga/ose në emër të industrisë së vendit”, vetëm nëse mbështetet:

a) nga prodhuesit shqiptarë, prodhimi i përbashkët i të cilëve përbën më shumë se 50 për qind të prodhimit total të produktit të ngjashëm, të prodhuar nga prodhuesit që janë shprehur pro ose kundër aplikimit;

b) nga prodhuesit shqiptarë, që shprehen pro aplikimit, prodhimi i të cilëve përbën jo më pak se 25 për qind të prodhimit total të produktit të ngjashëm të industrisë shqiptare.

6. Çdo aplikim, sipas dispozitave të këtij neni, mund të tërhiqet përpara fillimit të hetimit. Në këtë rast vlerësohet si të mos jetë bërë.

7. Kur komisioni vendos për të mos filluar hetimin, vendimi u njoftohet me shkrim aplikuesve nëpërmjet ministrisë përgjegjëse.

8. Ministria i kërkon komisionit të vendosë për fillimin ose jo të një hetimi për masa antidumping ose kundërbalancuese brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes me shkrim të aplikimit. Kur ministria i kërkon aplikuesit të dhëna shtesë, ky afat mund të shtyhet deri në 60 ditë.

9. Komisioni nuk fillon hetim për atë produkt të importuar, kur pretendohet se është:

a) objekt dumpingu, nëse nga të dhënat e mbledhura përcaktohet se kufiri i dumpingut është më i vogël se 2 për qind ose se vëllimi real dhe i ardhshëm i importeve të dumpuara është i papërfillshëm;

b) i subvencionuar, nëse nga të dhënat e mbledhura përcaktohet se shuma e subvencioneve është më e vogël se 2 për qind ose se vëllimi real dhe i ardhshëm i importeve të subvencionuara është i papërfillshëm.

Neni 28

Njoftimi për fillimin e hetimit

1. Ministria, sapo merr njoftim nga komisioni për fillimin e një procedure hetimi, duhet:
 - a) të njoftojë shtetet, produktet e të cilave janë objekt i hetimit dhe palët e interesuara, që kanë interesa, si eksportuesit, importuesit dhe shoqatat përfaqësuese të interesuara të importuesve ose eksportuesve, si dhe vendin e origjinës dhe/ose vendin eksportues dhe paditësit;
 - b) ta botojë në Fletoren Zyrtare dhe në një gazetë me qarkullim të madh në Republikën e Shqipërisë.
2. Botimi dhe njoftimet e tjera duhet të përmbajnë këto të dhëna:
 - a) emrin e vendit ose të vendeve eksportuese ose, nëse nuk është vendi në fjalë, emrin e vendit apo të vendeve të origjinës së produktit në hetim;
 - b) një përshkrim të produktit në hetim, përfshirë karakteristikat teknike, përdorimin dhe numrin aktual të klasifikimit;
 - c) përshkrimin e praktikave të dumpingut ose të subvencionimit;
 - ç) një përmbledhje të faktorëve, tek të cilët bazohet pretendimi i dëmit;
 - d) adresën, ku duhet të drejtohen përfaqësitë e palëve të interesuara;
 - dh) datën e fillimit të hetimit;
 - e) kufijtë kohorë, që u lejohen palëve të interesuara për të bërë të njohura vlerësimet e tyre.
3. Hetimi fillon në ditën që bëhet lajmërimi publik, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni.

Neni 29

Kohëzgjatja e hetimeve

1. Ministria, përveç rasteve të veçanta, duhet t'i mbyllë hetimet për masat antidumping ose kundërbalancuese brenda një viti dhe, në asnjë rast, jo më vonë se 18 muaj pas fillimit të tyre.
2. Procedura për masat antidumping ose kundërbalancuese nuk duhet të pengojë autoritetet doganore. Me marrjen e masave nuk kryhet asnjë formalitet tjetër shtesë, përveç atyre që lidhen me zbatimin e këtyre masave.

Neni 30

Dosja publike dhe e drejta e informimit

- Ministria, për çdo hetim apo rishikim, krijon, në përputhje me kërkesën për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, një dosje publike, e cila, herë pas here, plotësohet me:
- a) të gjitha raportet publike për hetimin apo rishikimin;
 - b) të gjitha materialet, përfshirë pyetësorët, përgjigjet e pyetësorëve dhe lajmërimet e shkruara, që i janë paraqitur komisionit;
 - c) të gjitha të dhënat e tjera, të formuluar ose të marra nga komisioni, përfshirë edhe ndonjë raport verifikimi të kryer;
 - ç) të gjitha dokumentet e tjera, të vlerësuara të përshtatshme për lajmërim publik.
- Dosja u vihet në dispozicion palëve të interesuara në çdo fazë, si gjatë hetimit apo rishikimit, edhe gjatë proceseve gjyqësore.

Neni 31

Mbledhja e të dhënave

1. Komisioni, me fillimin e hetimeve, nëpërmjet ministrisë, ka detyrimin t'i dërgojë pyetësor çdo personi që, sipas saj, mund të ketë të dhëna për çështjen në hetim, përfshirë këtu prodhues të njohur vendas, importues, eksportues, prodhues të huaj dhe qeverive të vendeve, produktet e të cilave janë objekt hetimi.
2. Komisioni do t'u japë eksportuesve, prodhuesve të huaj dhe të vendeve të interesuara, që marrin pyetësorë, të paktën, 45 ditë kohë për t'u përgjigjur. Ky afat kohor llogaritet nga dita e dërgimit

të pyetësorit ose nga dita kur i është transmetuar përfaqësisë diplomatike apo zyrtare të vendit eksportues. Komisioni duhet ta marrë parasysh, nëse ka dhe është e argumentuar, kërkesën për zgjatjen e afatit për dhënien e përgjigjes. Pyetësorët shkruhen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.

3. Komisioni, nëpërmjet ministrisë, mund t'u kërkojë, gjatë hetimit, palëve të interesuara të dhëna shtesë, në formën e pyetësorëve ose të kërkesave të shkruara, sqarime ose të dhëna të mëtejshme. Në këtë rast komisioni përcakton edhe afatin, brenda të cilit duhen dorëzuar përgjigjet.

Neni 32

Seancat dëgjimore

1. Me kërkesë me shkrim të çdo pale të interesuar, ministria planifikon një seancë dëgjimore, ku palët e interesuara, që cenohen nga rezultati i përfundimeve ose që kanë motive të caktuara, për të cilat duhet të dëgjohen, paraqesin të dhëna dhe argumente për çështjen në fjalë. Seancat dëgjimore zhvillohen jo më vonë se 60 ditë përpara datës së propozuar për marrjen e vendimit përfundimtar.

2. Sipas kërkesës, ministria duhet t'u krijojë palëve të interesuara mundësinë për t'u takuar. Nuk përbën detyrim për palët pjesëmarrja në takim dhe mospjesëmarrja, në asnjë mënyrë, nuk përbën paragjykim për asnjërën palë.

3. Palët e interesuara, që duan të përshihen në seancat dëgjimore, dërgojnë me shkrim në ministri emrat e përfaqësuesve dhe të dëshmitarëve, që do të paraqiten në seancë, të paktën 7 ditë para datës së seancës.

4. Palët e interesuara, gjithashtu, kanë të drejtë që, kur nuk janë dakord me vendimet e ministrisë, t'i paraqesin komisionit, gojarisht, gjatë takimeve, çdo të dhënë tjetër shtesë. Komisioni duhet të mbajë minutazh të hollësishëm dhe ta vendosë në dosjen publike, por pa të dhënat konfidenciale.

Neni 33

Kontributet e shoqatës së konsumatorëve dhe të përdoruesve

Ministria u krijon mundësi aplikuesve, qeverisë së vendit të origjinës dhe/ose të vendit eksportues, importuesve e eksportuesve dhe shoqatave të tyre, përdoruesve të produktit në hetim në Republikën e Shqipërisë, si dhe organizatave të konsumatorëve që, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, të kontrollojnë të gjitha të dhënat e përdorura gjatë hetimit, të cilat i janë dhënë komisionit nga një palë, si dokumentacion i veçantë e i brendshëm, i nevojshëm në paraqitjen e çështjeve të tyre, por që nuk është konfidencial, në kuptim të nenit 48 të këtij ligji. Palët kanë të drejtë të japin mendim për këto të dhëna dhe do të merren parasysh vetëm kur janë mjaftueshmërisht të vërtetueshme.

Neni 34

Vendimet përfundimtare

1. Ankuesit, importuesit, eksportuesit dhe shoqatat e tyre përfaqësuese dhe përfaqësuesit e vendit eksportues mund të kërkojnë zbulimin e të dhënave, të hollësive dhe fakteve të rëndësishme, në bazë të të cilave janë marrë masat. Kërkesa për zbulim duhet të bëhet me shkrim, menjëherë pas vendosjes së masave të përkohshme. Gjithashtu, palët e lartpërmendura mund të kërkojnë zbulimin përfundimtar të fakteve kryesore dhe të elementeve, në bazë të të cilave është menduar vendosja e masave përfundimtare, përfundimi i një hetimi ose i procedurave, pa vendosjen e masave.

2. Kërkesa për zbulimin përfundimtar i drejtohet ministrisë me shkrim dhe pranohet kur është zbatuar një taksë e përkohshme, jo më vonë se 1 muaj pas botimit/shpalljes së vendosjes së kësaj takse. Në rastet kur nuk zbatohet një taksë e përkohshme, palëve u jepet mundësia të kërkojnë zbulimin, brenda afateve kohore të vendosura nga komisioni.

3. Zbulimi përfundimtar duhet të jepet në formë të shkruar, me anë të një publikimi. Ky zbulim duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur, normalisht, jo më vonë se 1 muaj përpara vendimit përfundimtar ose pranimit nga komisioni të propozimit për marrjen e masave përfundimtare, duke pasur parasysh mbrojtjen e të dhënave konfidenciale. Kur komisioni nuk mund të zbulojë fakte ose elemente të caktuara për momentin, ky zbulim do të bëhet në një kohë të mëvonshme.

4. Nëse komisioni, në përfundim të hetimit, ka marrë një vendim, ai duhet ta bëjë publik

vendimin e marrë. Krahas botimit të vendimit, njoftimi duhet të përfshijë të gjitha të dhënat për faktet, ligjin dhe arsyet që çuan në këtë vendim, por duke u kujdesur për ruajtjen e të dhënave konfidenciale dhe në veçanti për:

- a) emrat e eksportuesve dhe të prodhuesve të njohur të produktit në hetim;
- b) përshkrimin e produktit në hetim, duke dhënë të dhëna aq sa është e mjaftueshme për veprime doganore (taksave doganore), përfshirë klasifikimin aktual shqiptar të tarifave;
- c) shpjegimet për dumpingun ose subvencionin, për periudhën e hetimit të dëmit të shkaktuar, nëse është aplikuar;
- ç) kufirin e dumpingut ose shumat e subvencionit të identifikuar dhe bazat, mbi të cilat është përcaktuar se ky dumping ose subvencion ekziston;
- d) faktorët që çuan në përcaktimin e dëmit dhe të lidhjes shkakësore, duke përfshirë edhe të dhënat për këta faktorë, përveç importeve të dumpuara ose të subvencionuara, që janë marrë parasysht;
- dh) çdo arsye tjetër, që ka çuar në vendimin përfundimtar;
- e) arsyet për pranimin ose refuzimin e argumenteve apo të padive përkatëse, të bëra nga eksportuesit dhe importuesit;
- ë) shumën e masave antidumping ose kundërbalancuese, të përcaktuara për t'u vendosur, duke përfshirë çdo vlerësim në interes të Republikës së Shqipërisë;
- f) rastet kur masat antidumping ose kundërbalancuese duhet të mbliidhen nga ato importe, për të cilat janë zbatuar masat paraprake, arsye për këtë vendim.

5. Njoftimi botohet në Fletoren Zyrtare dhe në një gazetë me qarkullim të madh në Republikën e Shqipërisë. Njoftimi i dërgohet edhe vendit, produktet e të cilit janë objekt i këtij përcaktimi, si dhe palëve të tjera, që dihet se janë të interesuara.

6. Pas daljes së vendimit përfundimtar, me kërkesë të bërë brenda 15 ditëve nga botimi i tij, ministria zhvillon mbledhje të veçanta, të hapura, me eksportuesit ose prodhuesit, që e kërkojnë këtë takim, për të shpjeguar metodologjinë e përdorur në llogaritjen e dumpingut ose të shumës së subvencionit, të zbatuar përfundimisht për produktet e këtij eksportuesi apo prodhuesi.

KREU VII PËRFUNDIMI I HETIMIT

Neni 35

Masat e përkohshme

1. Komisioni mund të vendosë masa të përkohshme, nëse ka filluar hetimi, sipas dispozitave të nenit 27 të këtij ligji, kur është bërë njoftim publik për këtë qëllim, nëse u janë krijuar mundësitë e duhura palëve të interesuara për të dërguar të dhënat dhe për të bërë komente, nëse është bërë një përcaktim pohues paraprak i dumpingut ose i subvencioneve dhe i dëmit pasues për industrinë shqiptare dhe nëse marrja e masave të përkohshme, për të parandaluar shkaktimin e dëmit, është në interes të Republikës së Shqipërisë.

2. Masat e përkohshme mund të jenë në formën e pagesave financiare shtesë ose të një garancie, një depozitë në para apo obligacione, jo më e madhe se kufiri i dumpingut ose masa e subvencionit të vlerësuar paraprakisht.

3. Në çdo rast, zbatimi i masave të përkohshme antidumping ose kundërbalancuese është kusht për qarkullimin e lirë në territorin e Republikës së Shqipërisë të produktit në hetim.

4. Masat e përkohshme do të vendosen jo më parë se 60 ditë, por jo më vonë se 9 muaj nga fillimi i procedurave të hetimit.

5. Shuma e masës antidumping ose kundërbalancuese të përkohshme nuk mund të kalojë, respektivisht, kufirin e dumpingut ose shumën totale të subvencioneve të kompensueshme, të vërtetuara në mënyrë të përkohshme dhe duhet të jetë më e vogël se ky kufi ose kjo shumë, nëse një masë më e ulët është e mjaftueshme për të eliminuar dëmin, që i është shkaktuar industrisë shqiptare.

6. Masat e përkohshme do të zbatohen për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj. Me kërkesë të eksportuesve, që zënë një përqindje të rëndësishme të tregut, komisioni mund të zgjasë periudhën e zbatimit të taksave të përkohshme, por jo më shumë se 9 muaj.

7. Në zbatim të masave të përkohshme zbatohen kushtet e parashikuara në nenin 41 të këtij ligji.

Neni 36
Angazhimet

1. Ministria mund t'i kërkojë komisionit pezullimin e hetimit pa vendosjen e masave të përkohshme ose përfundimtare, kur sigurohet se me marrjen e angazhimeve të kënaqshme vullnetare nga çdo eksportues, për të riparë çmimet ose për të ndërprerë eksportet me çmime, objekt i dumpingut, ose për të eliminuar apo kufizuar subvencionimin e eksporteve në vendin në fjalë, për aq kohë sa këto eksporte përfitojnë nga subvencionet e kundërbalancueshme, për eliminimin e efekteve dëmtoese të dumpingut ose subvencionit. Rritja e çmimit, sipas një angazhimi të tillë, nuk duhet të jetë më e madhe se vlera e nevojshme për të eliminuar kufirin e dumpingut ose shumën e subvencioneve të kundërbalancueshme dhe duhet të jetë më e vogël se ky kufi ose kjo shumë, nëse një rritje e tillë do të ishte e përshtatshme për të mënjeluar dëmtimin, që i është shkaktuar industrisë shqiptare.

2. Angazhimi për çmime mund të sugjerohet nga ministria ose edhe nga eksportuesi, por asnjë eksportues nuk detyrohet të hyjë në të tilla angazhime. Fakti që eksportuesit nuk marrin përsipër angazhime të tilla apo nuk pranojnë ftesën për një gjë të tillë, nuk ndikon, në asnjë mënyrë, në paragjykimin e çështjes. Angazhimet nuk do të pranohen dhe nuk bëhen të ditura nga vendet ose eksportuesit, në rast se nuk është bërë një përcaktim i përkohshëm pohues i dumpingut ose subvencionit dhe i dëmtimit të shkaktuar prej tyre.

3. Angazhimet e ofruara nuk pranohen, nëse ministria i vlerëson ato të papërshtatshme. Kur ministria vendos të mos e pranojë angazhimin, duhet të njoftojë eksportuesin për arsyet që çuan në përcaktimin e angazhimit si të papërshtatshëm dhe, sipas rastit, duhet t'u japë mundësi eksportuesve të paraqesin komente me shkrim për këtë çështje. Arsyet për refuzimin e këtij angazhimi duhet të paraqiten në vendimin përfundimtar.

4. Angazhimet e eksportuesit pranohen nga ministria dhe miratohen nga komisioni.

5. Kur angazhimet pranohen nga eksportues të veçantë gjatë hetimit, ato fillojnë të kenë efekt nga data e përfundimit të hetimit për vendin e origjinës dhe/ose eksportit.

6. Ministria i kërkon çdo eksportuesi, angazhimet e të cilit janë pranuar, të njoftojë periodikisht për plotësimin e këtyre angazhimeve dhe të lejojë verifikimin e të dhënave përkatëse. Komunikimi i këtyre të dhënave duhet t'u nënshtrohet dispozitave për konfidencialitetin. Mosdhënia e të dhënave të kërkuara përbën shkelje të angazhimit.

7. Ministria u kërkon palëve, të cilat ofrojnë angazhim, të japin një version jokonfidencial të këtij angazhimi, që të dhënat të jenë të disponueshme për palët e tjera të interesuara në hetim.

8. Në rastet kur ministria refuzon angazhimet, eksportuesi ka të drejtë të ankohe pranë komisionit, i cili, pasi kërkon sqarime nga ministria, vendos pranimin ose jo të kërkesës së eksportuesit.

9. Nëse angazhimet pranohen, hetimi për dumpingun ose subvencionin dhe dëmtimin e shkaktuar mbyllet. Në rast se hetimi është përfunduar me një përcaktim negativ të dumpingut ose subvencionit dhe dëmtimit të shkaktuar, angazhimi i marrë përfundon automatikisht, përveç rasteve kur një përcaktim i tillë ka ardhur kryesisht për shkak të ekzistencës së një angazhimi. Në këto raste, komisioni mund të vendosë vazhdimin e angazhimit për një periudhë të arsyeshme. Në rast se hetimi është përfunduar me përcaktim pozitiv të dumpingut ose subvencionit dhe dëmtimit të shkaktuar, angazhimi i marrë vazhdon, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

10. Ministria ka detyrimin të botojë njoftimin e marrëveshjes për marrjen e angazhimit, ku mund të përfshijë edhe elemente të tjera të kësaj marrëveshjeje.

11. Kur vërehet shkelje e angazhimeve, të marra në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ministria mund të ndërmarrë veprime të menjëhershme, që kanë të bëjnë me propozimin e komisionit, për vendosjen e menjëhershme të masave të përkohshme, duke përdorur të dhënat më të mira në dispozicion të saj. Gjithashtu, kur vërehet shkelje ose tërheqje e angazhimeve, vendosen taksa përfundimtare, në bazë të fakteve të treguara gjatë hetimit, që çuan në marrjen e angazhimit, kur hetimi është përfunduar me një përcaktim përfundimtar të dumpingut ose subvencionit dhe dëmtimit të shkaktuar.

Neni 37
Përfundimi pa miratimin e masave

1. Komisioni e mbyll hetimin pa marrë masa, në rast se një kërkesë tërhiqet në çdo kohë pas fillimit të hetimit, përveçse kur komisioni vendos ndryshe, si dhe hetimi mbyllet kur komisioni vendos se masat janë të panevojshme.

2. Një hetim mbyllet menjëherë, në çdo kohë, kur komisioni bindet se nuk ka të dhëna të mjaftueshme, qoftë për dumping ose subvencione dhe dëmtim, që justifikojnë vazhdimin e hetimit, ose kur komisioni përcakton se kufiri i dumpingut apo shuma e subvencioneve kompensuese është minimale, siç është përcaktuar në pikën 9 të nenit 27 të këtij ligji ose kur vëllimi i importeve të dumpuara apo të subvencionuara, aktuale ose potenciale, është i papërfillshëm, siç është parashikuar në pikën 3 të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 38

Njoftimi publik për mbylljen e hetimeve pa vendosjen e masave

Komisioni ka detyrimin të bëjë një njoftim publik për përfundimin e hetimit pa vendosjen e masave, duke i kushtuar kujdesin e duhur hollësive për marrjen e këtij vendimi, përfundimeve ligjore, si dhe duke ruajtur të dhënat konfidenciale.

KREU VIII

APLIKIMI DHE MBLEDHJA E MASAVE ANTIDUMPING OSE KUNDËRBALANCUESE

Neni 39

Respektimi i interesit të vendit dhe i rregullit të masës më të vogël

1. Kur ministria, pas shqyrtimit të fakteve, përcakton ekzistencën e dumpingut ose të subvencionit dhe dëmit të shkaktuar si pasojë e tyre dhe pasi është pasur parasysh interesi i Republikës së Shqipërisë, komisioni vendos masat përfundimtare antidumping ose kundërbalancuese. Në rast se janë në fuqi masat e përkohshme antidumping ose kundërbalancuese, ministria i propozon komisionit vendosjen e masave përfundimtare, jo më vonë se 1 muaj përpara skadimit të masave të përkohshme.

2. Masa antidumping ose kundërbalancuese nuk duhet të kalojë, respektivisht, kufirin e dumpingut ose shumën e subvencioneve, nga të cilat kanë përfituar eksportuesit dhe duhet të jetë më e vogël, në rast se është e mjaftueshme për të eliminuar dëmin, që i është shkaktuar industrisë shqiptare.

Neni 40

Vendosja dhe mbledhja e masave antidumping dhe kundërbalancuese

1. Masat antidumping ose kundërbalancuese duhet të marrin formën e pagesave financiare shtesë, në vlerë specifike ose të ndryshueshme. Masat antidumping ose kundërbalancuese janë të ndryshme nga taksat e tjera të importit, të vëna për produktet e importuara përkatëse. Masat antidumping ose kundërbalancuese duhet të mbliidhen nga autoriteti përkatës doganor, në masën e duhur, pa diskriminuar importet e produkteve, për të cilat, nga të gjitha burimet, vërtetohet se janë të dumpuara ose të subvencionuara dhe që shkaktojnë dëm, përveç importeve nga burimet, angazhimet e të cilave janë pranuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Në rastet kur ministria ka kufizuar kontrollin, të gjitha masat antidumping ose kundërbalancuese të zbatueshme mbi importet e bëra nga eksportues apo prodhues, që nuk janë përfshirë në hetim, nuk do të jenë më të mëdha se vlera mesatare e ponderuar e marzheve të dumpingut ose të shumës së subvencionit, të paraqitur për eksportues dhe prodhues të përzgjedhur, me kusht që komisioni nuk do të marrë parasysh kufirin e dumpingut ose shumën e subvencionit, të cilat janë zero ose minimale.

3. Komisioni mund të zbatojë masën e mbetur të detyrimit antidumping ose kundërbalancues për importet nga eksportuesit dhe prodhuesit e panjohur për komisionin në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar. Masa e mbetur e detyrimit antidumping ose kundërbalancues nuk mund të jetë më e madhe se mesatarja e ponderuar e marzheve të dumpingut ose masave individuale të subvencionit, të vendosura për eksportuesit dhe prodhuesit që u hetuan.

4. Asnjë produkt nuk mund të jetë, në të njëjtën kohë, objekt i masave antidumping dhe kundërbalancuese, për riparimin e së njëjtës gjendje, që rezulton nga praktika e dumpingut ose nga dhënia e subvencioneve për eksport.

Neni 41

Fuqia prapavepruese

1. Masat e përkohshme dhe masat përfundimtare antidumping dhe kundërbalancuese zbatohen për produktet, që hyjnë në qarkullim të lirë në Republikën e Shqipërisë, pas datës së hyrjes në fuqi të masës së marrë në përfundim të hetimit.

2. Kur është vendosur një masë e përkohshme dhe faktet e provuara përfundimisht tregojnë ekzistencën e dumpingut ose të subvencionit kundërbalancues dhe dëmtimit, komisioni vendos një masë përfundimtare antidumping ose kundërbalancuese, mbi pjesën e masës së përkohshme që do të mbliidhet. Kështu dëmtimi nuk do të ketë ndikim në krijimin e një industrie vendase, as në kërcënimin për dëmtim, përveçse kur arrihet në përfundimin se këto, në mungesë të masave të përkohshme, janë kthyer në dëm material. Në të gjitha rastet e tjera, masat përfundimtare mund të vendosen vetëm në datën e përcaktimit përfundimtar të kërcënimit.

3. Në rastin kur ministria ka vënë një masë të përkohshme më të ulët se masa përfundimtare antidumping ose kundërbalancuese, diferenca nuk do të mbliidhet. Nëse masa përfundimtare është më e ulët se masa e përkohshme, masa duhet të rillogaritet. Kur në përcaktimin përfundimtar masa del zero, masa e përkohshme nuk miratohet.

4. Një masë përfundimtare antidumping ose kundërbalancuese mund të vendoset për produktet, që kanë hyrë për konsum në Republikën e Shqipërisë, jo më vonë se 90 ditë përpara datës së aplikimit të masës, por jo më parë se fillimi i hetimit, nëse komisioni u ka dhënë mundësi importuesve për të komentuar dhe:

a) për produktin e dumpuar ose të subvencionuar ekziston një histori dumpingu ose subvencioni, sipas së cilës dëmtimi është shkaktuar nga importe masive, në një periudhë relativisht të shkurtër të një produkti të dumpuar apo që përfiton nga subvencioni kundërbalancues;

b) në mënyrë që të mos përsëritet një dëmtim i tillë, është i nevojshëm përcaktimi i shumës së masave antidumping ose kundërbalancuese, prapavepruese mbi këto importe.

5. Në rast të shkeljes ose tërheqjes së angazhimeve për mallrat e hyra në Republikën e Shqipërisë, jo më vonë se 90 ditë përpara aplikimit të masave të përkohshme, mund të vendosen masat përfundimtare, nëse ndonjë përcaktim prapaveprues nuk do të zbatohet mbi importet, që kanë hyrë përpara shkeljes ose tërheqjes së angazhimeve.

KREU IX

KOHËZGJATJA, RISHIKIMI DHE RIMBURSIMI

Neni 42

Kohëzgjatja

1. Masa antidumping ose kundërbalancuese është në fuqi për aq kohë sa është e nevojshme për të neutralizuar dumpingun ose subvencionin, që i ka shkaktuar dëmtim industrisë vendase.

2. Çdo masë antidumping ose kundërbalancuese përfundimtare hiqet jo më vonë se pesë vjet pas datës së vendosjes ose pas datës së rishikimit më të fundit, nëse rishikimi ka mbuluar si dumpingun apo subvencionin, edhe dëmin, me përjashtim të rasteve kur nga rishikimi është arritur në përfundimin se mbarimi i kësaj mase mund të çojë në vazhdimin ose rindodhjen e dumpingut apo subvencionit dhe të dëmtimit.

Neni 43

Rishikimi

1. Rishikimi fillon nëse ka të dhëna të mjaftueshme se skadimi i afatit të masave mund të çojë në vazhdimin ose rindodhjen e dumpingut apo të subvencionit. Kjo tregohet në bazë të të dhënave për vazhdimësinë e dumpingut apo të subvencionit ose të të dhënave, se heqja e këtij dëmtimi është pjesërisht ose vetëm për shkak të ekzistencës së masave.

Kur komisioni fillon një procedurë për rishikimin e masave të vëna, me nismën e vet, nga një kërkesë me shkrim ose në emër të prodhuesve vendas, masa mbetet në fuqi deri në daljen e rezultatit të

rishikimit.

2. Në kryerjen e hetimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, ministria duhet t'u mundësojë eksportuesve, importuesve, përfaqësuesve të vendit eksportues dhe prodhuesve vendas plotësimin me të dhëna apo kundërshtimin për çështjet e paraqitura në kërkesën e rishikimit. Në nxjerrjen e përfundimeve duhen pasur parasysh të gjitha të dhënat, e dokumentuara dhe të përshtatshme, të paraqitura për çështjen në fjalë, si dhe faktin se kur skadimi i afatit të masave mund të çojë në vazhdimin ose rindodhjen e dumpingut apo të subvencionit dhe të dëmtimit.

3. Komisioni, jo më vonë se 90 ditë para skadimit të masës, boton në Fletoren Zyrtare dhe në një gazetë me qarkullim më të madh në Republikën e Shqipërisë, njoftimin për heqjen e afërt të masave antidumping ose kundërbalancuese. Megjithatë, masat përfundimtare nuk mund të hiqen nëse komisioni, në një rishikim të filluar para datës së skadimit, me nismën e vet ose me një kërkesë të bërë sipas rregullave nga/ose në emër të industrisë shqiptare, nxjerr përfundimin se heqja e kësaj mase mund të çojë në vazhdimin ose rikrijimin e dukurisë dumping ose të subvencionit kompensues dhe dëmit. Procedura duhet bërë brenda 45 ditëve nga njoftimi publik i heqjes së afërt të masave antidumping ose kundërbalancuese përfundimtare.

4. Sipas këtij neni, komisioni nis një procedurë rishikimi, me nismën e vet ose me kërkesë me shkrim nga/apo në emër të industrisë shqiptare, pasi ka kaluar një periudhë e arsyeshme kohe, të paktën një vit, nga vendosja e masës përfundimtare antidumping ose kundërbalancuese, për të shqyrtuar nëse kërkesa paraqet të dhëna të mjaftueshme për domosdoshmërinë e një rishikimi të përkohshëm. Rishikimi i përkohshëm fillon kur kërkesa parashtrohet të dhëna të mjaftueshme për mosvazhdimin e masës dumping ose të subvencionit, si të panevojshëm dhe/ose se dëmtimi nuk do të vazhdojë apo do të rishfaqet nëse hiqet ose ndryshon masa. Nëse gjatë rishikimit komisioni përcakton se masa antidumping ose kundërbalancuese nuk është më e nevojshme, ajo duhet të hiqet menjëherë.

5. Kur një eksportues, produkti i të cilit është objekt i një mase përfundimtare antidumping ose kundërbalancuese, nuk është hetuar individualisht gjatë procesit të hetimit, për shkaqe të ndryshme, si refuzimi për bashkëpunim, komisioni, me një kërkesë me shkrim drejtuar eksportuesit, kërkon që ai t'i nënshtrohet një rishikimi të përsheptuar, për të caktuar një normë individuale të masës antidumping ose kundërbalancuese.

Neni 44

Rikthimi i fondeve (rimbursimi)

1. Importuesi mund të kërkojë kthimin e vlerave të mbledhura nga organet përkatëse, nëse ministria përcakton se marzhi i dumpingut ose shuma e subvencioneve, në bazë të të cilave është paguar kjo vlerë, është eliminuar ose reduktuar në një nivel më të ulët se niveli i masës në fuqi.

2. Importuesi, brenda 60 ditëve pas përfundimit të periudhës, bën pranë ministrisë një aplikim për kthimin e shumës së masave antidumping ose kundërbalancuese, të paguara brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data kur komisioni ka vendosur shumën e masave përfundimtare, që duhen mbledhur ose nga data e vendimit përfundimtar për mbledhjen e shumës.

3. Aplikimi duhet të përmbajë të dhëna për shumën e pretenduar për kthim dhe dokumentacionin e plotë doganor për llogaritjen e pagesës së kësaj shume. Aplikimi duhet të përmbajë edhe të dhëna për vënien re të masave antidumping ose kundërbalancuese, për eksportuesin ose prodhuesin, ndaj të cilit zbatohen masat. Nëse importuesi nuk është i lidhur me prodhuesin apo eksportuesin dhe kjo e dhënë nuk është menjëherë e disponueshme, ose kur prodhuesi apo eksportuesi nuk dëshiron t'ia japë atë importuesit, aplikimi duhet të përmbajë deklaratën e prodhuesit apo të eksportuesit për kufirin e dumpingut ose për reduktimin apo eliminimin e shumës së subvencioneve. Provat i jepen drejtpërdrejt ministrisë, për t'ia paraqitur komisionit. Kur provat nuk paraqiten brenda një periudhe kohe prej 60 ditësh, aplikimi refuzohet.

4. Komisioni, gjatë hetimit, në bazë të aplikimit për rikthim fondesh, vendos kur dhe në ç'masë do të bëhet kthimi. Gjithashtu, komisioni mund të vendosë fillimin e një rishikimi të përkohshëm, rezultatet e të cilit do t'i përdorë për të përcaktuar kohën dhe masën e kthimit. Ministria është e detyruar t'ia japë importuesit (palës që ka bërë aplikimin) shpjegime të hollësishme për marrjen e vendimeve nga komisioni, për fondet e kërkuara për kthim.

5. Kthimi i fondeve të masave bëhet brenda 12 muajve dhe, në asnjë rast, jo më vonë se 18 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës. Çdo kthim fondesh, mbështetur në të dhënat e sakta të importuesit të produktit, subjekt i masës antidumping ose kundërbalancuese, bëhet brenda 90 ditëve

nga data e marrjes së vendimit për kthimin e fondeve. Respektimi i këtyre afateve kohore mund të shkelet nëse vendimi është objekt i procedurave të rishikimit gjyqësor.

Neni 45
Mashtrimi

Kohëzgjatja e masave antidumping ose kundërbalancuese, të vëna në përputhje me këtë ligj, mund të shtyhet për produktet e ngjashme ose një pjesë të tyre, të importuara nga një vend i tretë, kur kemi të bëjmë me mashtrim të këtyre masave.

Me mashtrim, në këtë rast, kuptojmë ndryshimin e mënyrës së tregtisë ndërmjet vendit të origjinës dhe vendit importues, si rrjedhojë e praktikës, procesit apo punës, për të cilën ka arsye të pamjaftueshme ose justifikim ekonomik të ndryshëm nga ai i vendosjes së taksës dhe kur ka të dhëna se efektet rregulluese të masës po thellohen në terma të tillë, si çmimi dhe/ose sasia e produktit të ngjashëm, apo ka të dhëna për dumping për produktin e ngjashëm të importuar, si dhe kur importimi i produktit të ngjashëm ose i një pjese të tij vazhdon të përfitojë subvencion.

Neni 46
Verifikimi i të dhënave

1. Ministria, nëse e gjykon me vend, gjatë periudhës së hetimit ndërmerr hapa për verifikimin e të dhënave nga të gjitha palët, për vërtetësinë e tyre për dumpingun, subvencionin dhe dëmtimin, në bazë të të cilave është marrë vendimi, si dhe/ose kërkon të dhëna të tjera të mëtejshme.

2. Kur është e nevojshme, ministria mund të kryejë hetime edhe në vende të treta, brenda kushteve të miratuara nga shoqëritë përkatëse, si dhe pasi është njoftuar vendi në fjalë dhe është rënë dakord. Në këtë rast, komisioni përgatit raportin për verifikimin e të dhënave. Ky raport i vihet në dispozicion shoqërisë, ndërsa versioni jokonfidencial futet në dosjen publike.

3. Palët njoftohen për të dhënat, që do të verifikohen gjatë hetimit, megjithatë kjo nuk përbën pengesë për kërkesa e hollësi të tjera të mëtejshme, në funksion të verifikimit të të dhënave të siguruara.

Neni 47
Mosbashkëpunimi

1. Kur njëra nga palët e interesuara, e regjistruar si person juridik në Republikën e Shqipërisë, refuzon të vërë në dispozicion të dhënat e kërkuara ose nuk i siguron ato brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, ose me qëllim pengon hetimin, në këtë rast përfundimet do të nxirren në bazë të fakteve të disponueshme. Nëse vërtetohet se njëra nga palët e interesuara ka deklaruar të dhëna të rreme ose mashtruese, ato nuk do të merren parasysh dhe gjykimi do të bëhet në bazë të fakteve të disponueshme. Palët e interesuara duhet të jenë të ndërgjegjshme për pasojat e mosbashkëpunimit.

2. Nëse përcaktimet, përfshirë edhe ato për vlerën normale ose shumën e subvencioneve kundërbalancuese, janë bërë sipas pikës 1 të këtij neni, së bashku me të dhënat e formularit të aplikimit duhet të kontrollohen, kur janë të zbatueshme dhe brenda afateve kohore të hetimit, duke i krahasuar me të dhënat e mbledhura nga burime të tjera, të pavarura, si listat e botuara të çmimeve, statistikat zyrtare të importeve, të dhënat e mëparshme të doganave apo të marra gjatë hetimit nga palë të tjera të interesuara.

Neni 48
Konfidencialiteti

1. Të dhënat e marra përdoren vetëm për arsyet, për të cilat janë kërkuar.
2. Gjatë hetimit, komisioni dhe ministria mbajnë si konfidenciale të dhënat e siguruara në bazë konfidencialiteti. E dhëna konfidenciale nuk bëhet e ditur pa lejen me shkrim të subjektit, burim i kësaj të dhëne.

3. Të dhënat trajtohen si konfidenciale kur:

a) bërja publike e tyre ka efekte të pafavorshme për personin, që e jep këtë të dhënë ose

personin nga i cili janë marrë këto të dhëna;

b) palët argumentojnë se i kanë siguruar në bazë konfidencialiteti.

4. Palët e interesuara, që kanë siguruar të dhëna konfidenciale, duhet të paraqesin një përmbledhje me hollësi për këto të dhëna, por pa cenuar konfidencialitetin.

Në raste të veçanta, palët paraqesin arsye me shkrim, që justifikojnë se të dhëna të caktuara nuk mund të paraqiten as në përmbledhje.

5. Të dhënat nuk janë konfidenciale kur:

a) kërkesa për konfidencialitet nuk është e justifikuar;

b) edhe pse dhënësi nuk autorizon zbulimin e të dhënave, në çfarëdolloj forme, ato verifikohen nga burime të tjera të besueshme.

KREU X RISHIKIMI GJYQËSOR

Neni 49

Rishikimi gjyqësor

Çdo palë e interesuar, që ka marrë pjesë në një procedurë hetimi, rishikimi ose kthimi parash, mund të kërkojë, në çdo kohë, rishikimin e vendimeve përfundimtare, të marra nga komisioni dhe, në rast mosbindjeje, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

KREU XI DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 50

Detyrime ndërkombëtare

Ky ligj zbatohet në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, që Republika e Shqipërisë ka si anëtare e OBT-së, me nenet VI “Marrëveshja antidumping” e XVI “Marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalancuese” të “Marrëveshjes së përgjithshme për tarifatat dhe tregtinë” (GATT, 1994).

Neni 51

Shfuqizimet

Ligji nr.8466, datë 24.3.1999 “Për antidumpingun”, si dhe aktet e tjera nënligjore, të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5451, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**